

Gjendja aktuale e resurseve gjenetike të misrit

Prof.As. Dr. Kostandin Hajkola
QTTB Shkodër

Pas futjes massive të hibrideve të misrit në praktiken e kultivimit, epërsive që ato treguan në rritjen e prodhimit, popullatat lokale u mënjanuan nga përdorimi si material faror dhe teknologjik. Megjithatë, duke patur parasysh se ato janë produkt i një përshtatje shekullore me faktorët klimatik e teknologjik, atyre iu është kushtuar një vëmendje e veçantë nga institucionet kërkimore. Në Shqipëri, pas viteve 70 janë realizuar disa misione koleksionimi. Me i plotë është ai i realizuar në vitet 74-76, ku janë koleksionuar mbi 600 popullata lokale, kryesisht nga IMO dhe ILB. Në harkun kohor 1974-1990, ato kanë qenë pjesë e germoplazmes së misrit në ruajtje, e tipit ex-situ.

Pas karakterizimit dhe vlerësimit agromorfologjik të tyre, një pjesë e tyre është eliminuar pasi i përkisnin të njëjtës popullate. Gjate këtyre viteve është konstatuar se një pjesë e popullatave kanë reduktuar variabilitetin gjenetik brenda popullatës. Kjo për mungesë të kushteve për konservimin afatmesëm apo afatgjatë, nga shumëzimi herëpashërshëm i tyre në numër të kufizuar individësh për popullatë etj.

Në vitet 94-95, është bërë një koleksionim i dytë nga ish IMO Shkodër, kryesisht për disa popullata që kishin "humbur" në koleksionin e viteve 74-76. Në këtë koleksionim u grumbulluan 52 popullata në vëndorigjine. Me ngritjen e Bankës Gjenetike të Bimëve, fillimisht pranë ESHFF, pastaj me krijimin e Qendrës së Resurseve Gjenetike pranë Universitetit Bujqësor Tirane, ruajtja e këtyre burimeve gjenetike të misrit kaloi në formatin e konservimit afatgjatë. Në këto format ruhen 245 popullata me 2500-3000 kokrra për popullatë, linja të krijuara 450, me 250 kokrra për aksesion.

Të gjithë aksesionet, e mesipërme janë të dubluara dhe ruhen ex-situ pranë QTTB Shkodër. Përveç tyre, koleksioni i punës përfshin 850 linja të huaja dhe 150 linja të reja të krijuara në 10 vitet e fundit (metodat baze të aplikuara së fundmi janë ato: rikurent SRR, rikryqezimet, pool-e sintetike, MAS etj). Pas viteve 2000 janë realizuar koleksionime të pjesshme nga Banka Gjenetike, mbështetur nga projekte të ndryshme duke përfshirë një pjesë të popullatave nga vëndorigjina e tyre. Krahas kësaj është vazhduar me rigjenerimin e karakterizimin e tyre si pjesë përberëse e vlerësimit të diversitetit gjenetik që ato mbartin.

Koleksionimi i popullatave lokale të misrit është shoqëruar me rigjenerimin dhe ruajtjen e tyre. Në vazhdimësi janë kryer studime e vlerësime të shumta, agromorfologjike, gjenetike, ekonomike etj. Natyrisht që jo i gjithë koleksioni ka shfaqur interesa për vazhdimësinë e studimeve të tyre pasi në teresinë

koleksionit ka popullata te dubluara, te afërta gjenetiksht, disa edhe me probleme vitaliteti ne rigjenerim. Për te gjitha aksesionet e popullatave lokale te misrit ish IMO dhe QTTB Shkodër ne bashkëpunim me Bankën gjenetike te Shqipërisë ka kryer karakterizimin për disa tipare agromorfologjike (jo te gjitha sipas deskriptoreve ndërkombëtare te unifikuar), është plotësuar pasaporta e te dhënave baze tyre.

%